

INFORMATAT MBI PROGRAMIN E GJYKATAVE MODELE

<p>HISTORIA</p>	<p>Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore (NCSC) ka bërë implementimin e aktiviteteve të USAID-it në sektorin e drejtësisë në Kosovë që nga viti 2001. Nën Projektin për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (JSRAK, 2003-2007), NCSC-ja ka drejtuar disa pilot projekte në sektorët si audio incizimi, procesimi i lëndëve, zvogëlimi i vonesave dhe menaxhimi i regjistrave. JSRAK-u po ashtu ka ofruar trajnime për kryetarët dhe administratorët e gjykatave mbi kompetencat thelbësore në administrimin e gjykatave, si: menaxhimi i rrjedhës së lëndëve, buxheti dhe financat, resurset njerëzore, dhe teknologjia informative.</p> <p>Në korrik të vitit 2007, NCSC-ja e filloi projektin e ri nën mbështetjen e USAID-it: Projekti për Mbështetjen e Drejtësisë (KJSP), që përveç tjerash përfshinë edhe Programin e Gjykatave Modele (PGjM).</p>
<p>QËLLIMI</p>	<p>PGjM-ja ka një qasje gjithëpërfshirëse për përmirësimin e veprimeve dhe administrimit në gjykata. Kjo qasje do të rezultojë në zhvillimin e proceseve më të standardizuara me qëllim të rritjes së efikasitetit. Duke u larguar nga ato pilot aktivitete të izoluar, PGjM-ja përfshinë edhe institucionet lokale në të gjitha fazat e dizajnit dhe implementimit për të siguruar se vizioni për gjyqësorin e Kosovës i caktuar nga KGjK-ja të mund të bëhet realitet.</p>
<p>PARTNERITETI</p>	<p>PGjM është një partneritet midis USAID-it, Projektit për Mbështetjen e Drejtësisë në Kosovë (KJSP), Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), dhe gjykatave pjesëmarrëse. KJSP-ja me financim nga USAID-i, dhe e implementuar nga Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore (NCSC) punon me KGjK-në për të zhvilluar dhe implementuar PGjM-në me 10 gjykata pjesëmarrëse gjatë një periudhe tre vjeçare. Gjykatat pjesëmarrëse do të jenë partnerë aktiv në testimin dhe rafinimin e standardeve dhe praktikave më të mira që kanë të bëjnë me veprimtarinë dhe administrimin e gjykatave.</p>
<p>PROCESI PËRZGJEDHËS</p>	<p>Në dhjetor 2007, është përzgjedhur një grup prej gjashtë gjykatave—Gjykata Ekonomike, Gjykatat Komunale në Ferizaj, Gjilan dhe Prizren, dhe Gjykatat e Qarkut në Mitrovicë dhe Pëjë—që të marrin pjesë në PGjM. Procesi i përzgjedhjes ishte dizajnuar në atë mënyrë që t'ia mundësojë gjykatave të interesuara aplikimin përmes një procesi garues të hapur. Ky proces përzgjedhës është zhvilluar në koordinim me KGjK-në dhe kriteret janë finalizuar përmes të një komisioni në të cilin janë përfshirë përfaqësues të gjyqtarëve dhe administratorëve të gjykatave, stafi i KJSP-së, si dhe stafi i Sekretariatit të KGjK-së. KGjK-ja ka mbështetur përzgjedhjen finale.</p> <p>Për më tepër edhe katër gjykata shtese janë zgjedh në muajin prill 2009: Gjykatat Komunale në Gjakovë, Kamenicë, Prishtinë, dhe Skenderaj. Gjykatat janë zgjedhë bazuar në një seri kriteresh të vendosura nga KJSP, me qëllim të përfshirjes së përfaqësimit të të gjitha distrikteve, për ndërtuar partneritet me Gjykatat modele ekzistuese, si dhe për të iniciuar punën në shtatë qendrat më të mëdha komunale.</p>

INFORMATAT MBI PROGRAMIN E GJYKATAVE MODELE

<p>STANDARDET PËRMIRËSUESE NË GJYKATA: QËLLIMI</p>	<p>PGjM qeveriset me anë të Standardeve për përmirësim e gjykatave si udhëzues për aktivitete e ndërmarra nga gjykatat pjesëmarrëse. Standardet për përmirësimin e gjykatave janë të dizajnuara si një sërë principesh kyçe të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reflekojnë praktikat më të mira ndërkombëtare në administrimin dhe operimin e gjykatave. • Ofrojnë një udhëzues për gjykatat pjesëmarrëse gjatë implementimit të ndryshimeve dhe vlerësimit të ndikimit të tyre. • Sigurojnë mjete dhe mënyra komunikimi përbrenda gjyqësorit dhe me publikun. • Standardizojnë reformat që konsiderohen si prioritete nën Planin Strategjik të KGjK-së për gjyqësorin e Kosovës për periudhën 2007-2012. • Suspendojnë rregullat ekzistuese për të pilotuar mënyra të reja të veprimit dhe me këtë identifikojnë zgjidhjet më të mira ndaj sfidave me të cilat përballet gjyqësori i Kosovës.
<p>STANDARDET PËR PËRMIRËSIMIN E GJYKATAVE: PËRMBAJTJA</p>	<p>Standardet për përmirësimin e gjykatave janë zhvilluar bazuar në dokumentet burimore mbi praktikat më të mira në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë, Planin Strategjik të KGjK-së për gjyqësorin e Kosovës për periudhën 2007-2012, Rregullat mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave që janë në fuqi si dhe Planin për implementimin e standardeve në Kosovë. Standardet janë finalizuar nga komisioni që përfshinë përfaqësues nga gjyqtarët dhe administratorët e gjykatave, stafin e KJSP-së, dhe stafin e Sekretariatit të KGjK-së.</p> <p>Standardet hyjnë në pesë kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i përgjithshëm dhe menaxhimi <p>Lidershipi është energjia prapa sistemit të gjykatave dhe arritjeve të tyre, derisa menaxhimi është organizimi dhe harmonizimi i resurseve për të arritur suksesin. Katër shtyllat e menaxhimit janë: planifikimi, organizimi, udhëzimi dhe monitorimi. Lidershipi dhe menaxhimi janë sisteme të domosdoshme të veprimit. Gjykatat kanë nevojë për njerëz që janë kompetentë, profesionalë, etikë dhe të zotuar. Menaxhimi i resurseve njerëzore mundëson performancë më të mirë dhe kontribuon në efikasitetin e gjykatës.</p>

INFORMATAT MBI PROGRAMIN E GJYKATAVE MODELE

	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i lëndëve dhe regjistrave <p>Menaxhimi i lëndëve, që ndonjëherë i referohen si zemra e administrimit të gjykatës, është një proces me të cilin gjykatat i kryejnë funksionet e para të lëvizjes së lëndëve nga parashtrimi i tyre e deri te mbyllja, duke siguruar se palët e përfshira kalojnë nëpër një proces që kryhet në kohë të duhur dhe me mbështetje të barabartë. Menaxhimi i regjistrave është i domosdoshëm për të siguruar saktësi, disponueshmëri të të gjitha regjistrave, si dhe ruajtje dhe deponim të duhur të regjistrave të vjetër.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zvogëlimi i ngarkesave me lëndë të prapambetura dhe i vonesave <p>Shkurtimi i vonesave bazohet në teknikat për të identifikuar shkaqet për vonesa gjatë procedimit të lëndëve të tashme dhe atyre që do të vijnë në të ardhmen. Zvogëlimi i ngarkesave me lëndë të prapambetura zhvillon strategji për të adresuar ngarkesat e tanishme dhe të parandalojë grumbullimin e mëtutjeshëm të lëndëve të prapambetura, pa ndërhyrë në procesim në kohë të duhur të ngarkesave me lëndë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhim financiar dhe buxhetor <p>Fakti se si gjykatat i gjejnë resurset, i marrin dhe i menaxhojnë ato ndikon në veprimet e secilës gjykatë dhe përcakton se si gjykatat e përmbushin mandatin e tyre dhe i shërbejnë publikut.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qasja e publikut dhe transparenca <p>Është e qartë se informatat në komunitet dhe në publik në përgjithësi e përmirësojnë performancën e gjykatës dhe e rrisin besimin e publikut në gjyqësor. Qasja në drejtësi përfshinë vetëdijesimin e publikut mbi shërbimet e gjykatës, qasjen strukturale, dhe mënyrat se si pjesëmarrësit akomodohen me vështirësitë me gjuhën, kulturën dhe lëvizshmërinë.</p>
<p>PËRMIRËSIMET NË OBJEKTE</p>	<p>Me mbështetjen e KJSP-së, secila gjykatë pjesëmarrëse do të ketë shansin të planifikojë përmirësimet që janë të drejtuara drejt shndërrimit të gjykatave në objekte më të qasshme, të sigurt dhe më funksionale.</p> <p>Renovimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj, pritet të përfundojnë në shtator 2009. Gjykata e qarkut dhe komunale në Pejë, gjykatat komunale në Prizren dhe Skenderaj, dhe Gjykata Ekonomike do të ndihmohen menjëherë. Renovimet e vogla gjithashtu janë planifikuar në gjykatat komunale në Gjakovë, Gjilan, Kamenicë, dhe Prishtinë.</p>

INFORMATAT MBI PROGRAMIN E GJYKATAVE MODELE

<p>PLANET E VEPRIMIT TË GJYKATAVE</p>	<p>Pas përzgjedhjes, secila gjykatë pjesëmarrëse ka zhvilluar Plane individuale të veprimit për gjykata me qëllim të implementimit të nënte Standardeve për përmirësimin e gjykatave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgjegjësitë administrative të Kryetarit të Gjykatës, Administratorit të Gjykatës dhe stafit mbështes. 2. Trajnimi për stafin mbështes. 3. Menaxhimi i lëndëve dhe regjistrave. 4. Zvogëlimi i ngarkesës më lëndë të prapambetura. 5. Përmeshja e standardeve kohore. 6. Prokurimi dhe përdorimi i pajisjeve. 7. Komunikimi publik. 8. Siguria dhe qasja në gjykatë. 9. Seancat e hapura. <p>Planet e veprimit të secilës gjykatë janë udhëzues për implementimin e PGjM-së dhe përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Afatet për përmeshjen e kërkesave për secilin standard. • Krijimi i një komisioni të brendshëm i përbërë nga gjyqtarët dhe stafi jo gjyqësor për të mbikëqyrur implementimin e planit të veprimit. • Indikatorë dhe aktivitete për qëllimet e implementimit dhe monitorimit.
<p>ROLI I KJSP –SË</p>	<p>Stafi i KJSP-së që mbështet PGjM-në përfshinë ekspertë lokalë dhe ndërkombëtarë. Ata shërbejnë si ndihmës dhe mentorë për gjykatat pjesëmarrëse. KJSP-ja sponsorizon trajnimet për të ngritur kapacitetet e gjyqtarëve dhe stafit jo gjyqësor në gjykatat pjesëmarrëse që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë më efikase dhe të mund të sillen si udhëheqës përbrenda gjyqësorit të Kosovës. Pjesëmarrësit në PGjM po kontribuojnë në ngritjen e standardeve profesionale të gjykatës dhe në përmirësimin e besimit të publikut, dhe me këtë në të shërbyerit si modele për gjyqësorin e Kosovës.</p>
<p>STRUKTURA QEVERISËSE</p>	<p>Procesi qeverisës për PGjM është themeluar në koordinim me KGjK-në dhe Komisionin për Administrimin e Gjykatave.</p> <p>Secila gjykatë pjesëmarrëse do të ketë grupin e vet drejtues i përbërë nga gjyqtarët dhe stafin jo gjyqësor për të implementuar dhe monitoruar planin e tyre të veprimit. Kryetarët dhe administratorët e gjykatave nga secila gjykatë pjesëmarrëse do të takohet në baza periodike si Konzorcium i gjykatave modele për të shkëmbyer informata mbi sukseset dhe sfidat.</p>